



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 248/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osman i anëtarë, duke vodosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Dardanë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Dardanë, për shkak të vendosjes së posterave mbi rrugë publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Dardanë, subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### Arsyvetim

Me datën 11.10.2013, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga LVV, në të cilën theksohet se me datën 10.10.2013, në lagjen "Malësia", në rrugën "Dëshmorët e Kombit" në Dardanë, anëtarë të AAK-së, kanë vendosur posterin e kandidatit për kryetar komune, Lulzim Peci mbi rrugë publike, ku me këtë veprim sipas parashtruesit të ankesës wshtw shkelur neni 33 pika b i LZP-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi, për shkeljen e pretenduar.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik AAK, me datën 17.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 18.10.2013.. Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga AAK, në të cilën theksohet se vendosja e banerit të kandidatit të AAK-së mbi rrugë publike nuk është bërë nga strukturat e AAK-së, dhe se pretendon se kjo vendosje e banerit është bwrw nga qytetar apo individ te pidentifikuar. AAK konfirmon se me të pranuar njoftimin për varjen e banerit mbi rrugë publike nga strukturat menaxhuese te fushatës konkretisht Shtabi Zgjedhor ka bërë largimin e këtij baneri., me propozim qw PZAP-i, të merr për bazë veprimet e ndërmarra nga ana e tyre komfor neni 3 pika 3,4 dhe 3.6 tw Rregullës Zgjedhore Nr.11/13. .

Bashkangjitur më përgjigjen në ankesë AAK, ka dërguar Udhëzimin e Kryetarit të AAK-së drejtuar të gjitha strukturave për respektimin e ligjit mbi zgjedhjet dhe rregullat zgjedhore, fotot me të cilat dëshmohet se wshtw larguar baneri nw fjalw si dhe kërkesën e drejtuar Shefave të Shtabeve Zgjedhore për respektimin e Kodit Zgjedhor.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### Ankesë është e bazuar

Sepse me datën 10.10.2013, në lagjen "Malësia", në rrugën "Dëshmorët e Kombit" në Dardanë, anëtarë të AAK-së, kanë vendosur posterin e kandidatit për kryetar komune,

Lulzim Peci mbi rrugë publike, ku me këtë veprim sipas parashtruesit të ankesës janë shkelur neni 33 pika b e LZP-së.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fonave të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga fotografitë e ofruara si provë, nga parashtruesi i ankesës, të bashkangjitura shkresës së lëndës, shihet qartë se posteri i kandidatit për kryetar komune nga radhët e AAK-së, është i vendosur mbi rrugët publik të cilin veprim PZAP-i, konstaton se është në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se AAK, ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe faktin se posterat e kandidatit për kryetar komune në Dardanë kanë qenë të vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e posterave. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se AAK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjës në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitim e shkeljes, duke i larguar menjëherë banerin nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

Andaj PZAP-i, duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e AAK-së është shkelur neni 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) i LZP-së, pasi që baneri i kandidatit për kryetar të komune i AAK-së wshtw vendosur mbi rrugët publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëherësme të subjektit politik AAK-së, për evitim e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjës në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it, nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresë në Prishtinë

Anr. 248/2013 më datën 25.10.2013.

Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.